

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Deklarata në PD - Kedhi: Rama u izolua në New York, aleatët i kthyen shpinën, regjimi i tij është i braktisur brenda dhe jashtë vendit
ADRESA	https://www.syri.net/politike/919724/kedhi-rama-u-izolua-ne-new-york-aleatet-i-kthyen-sh-pinen-regjimi-i-tij-eshte-i-braktisur-brenda-dhe-jashte-vendit/
BURIMI	syri.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	28 shtator 2026, 13:19:47 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	28 shtator 2026, 12:46:36 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	65a6dceb0e0c5891124d8dfcb7bf3722636d3c7708e0a81f568dc5907e18b4c4
TEKSTI	ef4aad7e247688b0dd55e2ea3cc2b472ac2d8b2d69e34bb0edb2bc0d6aa81553
PAMJA	003e1ea55e1a268d106d4fd4f6440beef9d4ff271d8078531ca0f64cba4e43a7

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	63780b6517a785b4005621c9f1d281619071e335eae0ad298343db1ea05f1ec0
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	c9da2c073e2a83be1965121fd231137d695108173d39514ad5452b64d4c51b05
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/63780b6517a785b4005621c9f1d281619071e335eae0ad298343db1ea05f1ec0>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px




ÇIM PEKA

'Nuk e dija, nuk mjafton më'




FATMIR MEDIU

Rama heshti për Kosovën në OKB, nuk i kundërvu Vuçiçit dhe zgjodhi të flasë për Diellën



më të lexuarat



'Iu hoq cipa e maskës mazhorancës', Goxhaj: Po i vjen fundi kësaj kaste, Rama s' menaxhon dot më



'Asnjë hap pas'/ Dita e 120-të e protestave, pankartat: Edi, po të vjen fundi me ndëshkim!



VIDEO/ Balliu: A ka folur Edi Rama me Ergys Agasin përmes telefonit të Vlorë Hysenit?



Epitafi i frikës, apo frika e epitafit?



Berisha: Vlorë Hyseni është kthyer për t'u dhënë restin bashkëpunëtorëve të vet që e tradhtuan



Berisha: Foltoret e Ripërtëritjes në Vlorë dhe Elbasan dëshmuar se orteku i opozitës po rritet çdo ditë



Kedhi: Rama u izolua në New York, aleatët i kthyen shpinën, regjimi i tij është i braktisur brenda dhe jashtë vendit

14:46, 28/09/2026

ZMADHO TEKSTIN



Nënkryetari i PD-së, Nikola Kedhi tha se Edi Rama u refuzua nga të gjithë në Asamblenë e OKB në Neë York. Fjalimi i tij u mbajt përpara një salle bosh, ndërsa fjala e tij nuk u përfshi as në videon përmbledhëse të OKB-së me folësit e Asamblesë së Përgjithshme.

"Pas vitesh propagande që e shiste veten si "lider global", ajo që mbeti nga Nju Jorku ishte pamja e një njeriu të braktisur, pa agjendë, pa takime, pa njoftime për shtypin. Kjo nuk është braktisja e Shqipërisë. Shqipëria është vend anëtar i NATO-s, me aleatë të fortë dhe miq historikë. Kjo është braktisja e Edi Ramës dhe e një regjimi të cilin bota e njuh për atë çka është dhe i rri larg si murtajës' theksoi Kedhi në një deklaratë për median nga selia e PD-së.

E ndërsa presioni i partnerëve ndërkombëtare po rritet dita-ditës, Kedhi nënvizon se askush nuk do ta bëjë punën tonë në vendin tonë.

"Na takon ne, shqiptarëve, ta largojmë Ramën dhe ta shpëtojmë Shqipërinë nga rreziku që ai paraqet dhe nga turpi që na shkakton përditë. Sot, më shumë se kurrë, duhet ta bëjmë detyrën tonë dhe t'i japim këtij regjimi shtytjen e fundit."

Deklarata e nënkryetarit të PD, Nikola Kedhi:

Në javën kur udhëheqësit e botës mblidhen në Asamblenë e OKB në New York, ku diplomacia zhvillohet jo vetëm në foltoren e OKB-së, por sidomos në takimet dypalëshe, Edi Rama nuk pati asnjë takim.

Ndërkohë që drejtuesit e vendeve të rajonit takoheshin me liderët e botës, ndërtonin marrëdhënie dhe mbronin interesat e vendeve të tyre, Kryeministri i Shqipërisë u refuzua nga të gjithë. Edhe kur foli, e bëri përpara një salle bosh, ndërsa fjala e tij nuk u përfshi as në videon përmbledhëse të OKB-së me folësit e Asamblesë së Përgjithshme.

Pas vitesh propagande që e shiste veten si "lider global", ajo që mbeti nga Nju Jorku ishte pamja e një njeriu të braktisur, pa agjendë, pa takime, pa njoftime për shtypin.

Kjo nuk është braktisja e Shqipërisë. Shqipëria është vend anëtar i NATO-s, me

aleate te forte dhe miq historike. Kjo eshte braktisja e Edi Rames dhe e nje regjimi të cilin bota e njeher për atë çka është dhe i rri larg si murtajës.

Nuk mund ta takonin, kur shefja e Shërbimit Informativ të Shtetit vendoset në arrest shtëpie, ndërsa dalin lidhjet e saj me Ergys Agasin, koordinatorin e krimit të organizuar.

Nuk mund ta takonin kur krimi është tashmë pushteti dhe shtyllat e Republikës kanë rënë.

Nuk mund ta takonin, kur Shqipëria cilësohet narkoshteti i parë dhe i vetëm i Europës.

Nuk mund ta takonin, kur ai akuzohet për trafik ndërkombëtar armësh në përgjimet e publikuara nga ish-zëvendësi i tij.

Nuk mund ta takonin, kur raporti i OSBE/ODIHR thotë qartë që nuk ka zgjedhje të lira e të ndershme.

Nuk mund ta takonin për shumë e shumë arsye të tjera, që kanë cenuar sigurinë e Shqipërisë dhe të vetë Aleancës së NATO-s.

Ato që ndodhin sot në Shqipëri janë të paimagjinueshme për partnerët tanë ndërkombëtarë. Prej tyre nuk mund të vinte gjë tjetër veçse refuzim dhe përbuzje. Ata e kanë kuptuar rrezikun që Rama dhe regjimi i tij përbëjnë për Shqipërinë dhe për rajonin dhe e kanë braktisur. Ashtu siç e kanë braktisur prej kohësh shqiptarët që i kanë dalë kundër duke e manifestuar këtë prej katër muajsh çdo natë në çdo shesh.

Shqipëria nuk ka qenë gjithmonë kështu. Kur qeveriste Partia Demokratike, Shqipëria ishte një aleat serioz, i përgjegjshëm dhe i palëkundur në rrugën e saj euroatlantike. Një vend që fitonte respekt, që fitonte liberalizimin e vizave, një vend që u bë anëtar i NATO-s. Të gjitha këto sepse aleatët i besonin.

Presioni i partnerëve ndërkombëtarë po rritet dita-ditës dhe ne e shohim me çdo skandal që del në dritë. Kjo ndryshon tërësisht edhe raportet e forcës brenda vendit. Regjimi nuk ka qenë kurrë më i dobët: i izoluar jashtë, i refuzuar brenda, i braktisur nga të gjithë.

Por, askush nuk do ta bëjë punën tonë në vendin tonë.

Na takon ne, shqiptarëve, ta largojmë Ramën dhe ta shpëtojmë Shqipërinë nga rreziku që ai paraqet dhe nga turpi që na shkakton përditë. Sot, më shumë se kurrë, duhet ta bëjmë detyrën tonë dhe t'i japim këtij regjimi shtytjen e fundit.

© SYRI.net

Lexo edhe:



SYRI TV/ Begaj mbledh këshillin e Sigurisë Kombëtare, asnjë diskutim për kompromentimin e SHISH! U! Ramën përballë Spahos




Përplasja e gardistëve të Ramës me gazetaren Ambrozia Meta/ AGSH: S'mund t'i mohohet aksesit për pyetje



Begaj mbledh këshillin e Sigurimit, se Vlora e SHISH fliste me Agasin. Por vetë Rama fliste e bënte gosti me koordinatorin

Fjalimi i turpshëm në OKB/ Berisha: Rama, armik i egër i Kosovës, tani po përhap shpifje të ulëta kundër VV-së



'Mos kujtoni se ju kam vjedhur'/ Këlliçi-Ramës: Je kreu i narkoshtetit dhe kryehajduti i shqiptarëve, jep menjëherë dorëheqjen



'Zullumi po e kap për fyti Ramën', Noka në Tepelenë: Skandalet e kanë zhveshur totalisht

TË NGJASHME



SYRI TV/ Rama sërish presion BE me Kinën e Rusinë, flet për gangsterin rus dhe lodrat kineze



Një poezi të Dritëro Agollit, sundimtari në ditët e fundit të tij deshi ta kthente në mburojë



Kuvendi e quan të papranueshëm konstatimin e Speciales për 'qëllimin e përbashkët kriminal' nga katërshja e UÇK-së



'Mazhoranca po krijon mburojë për korrupsionin', Vokshi: Paratë e krimit po deformojnë ekonominë



Ina Zhupa: I vetmi akt që i shërben



Emiri: Artisti s'mund të konsiderohet



I dooiën shtëninë e prindërve gazetari

...sigurisë kombëtare është dorëheqja e Ramës.

...si një punëtor i zakonshëm, kërkohet Statusi i Artistit

...në Kosovë Vudi Xhymshiti poston pamjet: Nuk ndalem...

LAJME POLITIKË KRONIKË EKONOMI KOSOVA BOTË KULTURË SHKENCË SPORT JETË/STIL TRASHËGIMI MJEDIS ARKIVA



SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do ti gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojmë të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendoni se duhet. Stafi i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.